



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 2300 Prot.

Lezhë, më 01 . 03 .2021

V E N D I M

Nr 41 , Datë 24 / 02 / 2021

“ Për miratimin në parim të shpronësimeve për interes publik të listës së pronave private që janë prekur nga rikonstruksion e sistemim blloku “ILIRIA” lagjja Skënderbeg”

Mbështetur në nenin 41 të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, nenin 8, pika 3 e nenin 26, nenin 54 dhe në ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

V E N D O S I:

1. Të miratojë shpronësimin në vlerën prej 459.594 (katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë për pasurinë pronë private e Z. Kel Paluca me certifikatë pronësie me nr. 13945 me datë 16.10.2017 lëshuar nga ZVRPP Lezhë me numër pasurie 10/649, pasuri që ndodhet në zonën kadastrale 8631 që është prekur nga investimi Rikonstruksion e Sistemim Blloku “ILIRIA” Lagjja Skënderbeg.
2. Fondi i Shpronësimit në vlerën prej 459.594 (katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër) lekë është parashikuar në buxhetin e vitit 2020. Lëvrimi i fondit do të kryhet pasi të jetë miratuar VKM-ja përkatëse për shpronësimin në fjalë dhe të jetë publikuar në fletoren zyrtare.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike që të ndjekë procedurën e shpronësimit në Agjencinë Shtetërore të Shpronësimeve.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

K R Y E T A R I

ERNEST RAKAJ

